

## Studim i thukët mbi dallimin e qëndrimeve në Islam

Dr. Hatim el-Haxh, PhD në fushën e fikhut krahasues nga universiteti el-Xhinan, Tripoli, Liban

### Parathënie

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit të përhershëm

Një veçori e zakonshme e shoqërive njerëzore është mospajtimi, që është një dukuri e vazhdueshme dhe s'mund të shmanget krejtësisht në asnjë mënyrë. Në dimë me siguri se qeniet njerëzore nuk do të pushojnë se kundërshtuari, meqë kështu caktoi Allahu ﷻ për ta:

“Po të donte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit një komunitet të vetëm, por ata s'do të pushojnë së dalluari mes vete, përveç atyre që i mëshiron Zoti yt. Dhe për këtë Ai i krijoi.” (Hud, 118-119)

Mbetet të thuhet se dallimi në qëndrime s'është i tëri i mirë apo i tëri i keq. Ka etiketa të trajtimit të dallimeve që s'mund të zbriten në nivelin e një këshille të përgjithshme për tolerancë, pranim dhe butësi, ndonëse këto cilësi janë të lavdërueshme. Pra, disa dallime mund të mos pranohen. Me fjalë të tjera, dallimi mes të vërtetës dhe të pavërtetës vazhdon të mbeten ashtu siç vazhdon të mbetet e mira dhe e keqja.

Në këtë paraqitje, do të diskutohen çështje të mospajtimit, rrënjët e tyre, llojet, manifestimet, dhe trajtimi i tyre.

### Hyrje

Fjala *khilaaf* në arabisht do të thotë një mospajtim i thjeshtë, një kundërshtim, apo dhe një konflikt përfshirës që çon në përçarje (*shikaak*).<sup>1</sup> *Khilaaf* nuk çon detyrimisht në përçarje, por, edhe nëse kjo ndodh, mund të jetë apo të mos jetë me vend, varësisht nga shkaku i mospajtimit, lloji dhe shtrirja e tij.

Në çdo rast ka ekstreme në trajtimin e dukurisë së mospajtimit dhe të mesatares. Shumë muslimanë ankohen për shkallën e mospajtimit që ndodh mes nesh. Disa muslimanë, madje, vejnë në pyetje edhe shtrirjen e dallimit të Islamit nga fetë e tjera. Ndërsa të gjithë ankohemi për këtë përçarje, disa prej nesh janë vetëm të interesuar që ajo të zhduket, pa treguar ndonjë interesim për ruajtjen e vetë fesë.

Dëshira për të mos parë dallime mes njerëzve është e lavdërueshme. Megjithatë, për t'iu shmangur ekstremizmit edhe në këtë dhe për t'u mos u shqetësuar së tepërmi nga këto dallime, duhet të pranojmë se këto janë pjesë të

<sup>1</sup> Wehr and Cowan, A Dictionary of Modern Written Arabic, 298

sprovës që na vjen nga Allahu ﷻ, pra pjesë e pandashme e kësaj jete. Allahu ﷻ thotë:

“Ne i bëmë sprovë disa prej jush për të tjerët. A nuk do të duroni? Dhe Zoti yt sheh çdo gjë.” (el-Furkan, 20)

Në anën tjetër, gjejmë ata që nuk kuptojnë se dy persona të dijsëm e të sinqertë mund të arrijnë në dy përfundime kundërthënëse. Për të këtuillët mospajtimet bën të ndodhin vetëm në disa çështje. Është interesante sesi këta dallojnë edhe mes vete rreth spektrit të këtyre çështjeve; kjo për shkakun se, ndarja që orvaten ta instalojnë mes dallimeve të arsyeshme dhe të paarsyeshme, është artificiale, e zhvendosur larg nga kufijtë e duhur. Një student i dijes, që është në procesin e bërjes së një predikuesi, mësuesi, imami a aktivisti, duhet patjetër të zhvillojë të kuptuar të drejtë të këtyre kufijve.

Shpresoj se ky punim do të shërbejë si një analizë e kësaj dukurie dhe si një hartë që do të ndihmojë në orientimin në këto kohë konfuze për sa i përket trajtimit të duhur të mospajtimit, në mënyrën që do të respektojë edhe shenjtërinë e fesë sonë, edhe nevojën për unitet brenda umetit dhe ndërtimin e urave mes nesh dhe popujve të tjerë.

## Llojet e dallimeve

Sa u përket raporteve mes qëndrimeve të ndryshme, ka dy lloje dallimesh:

- Dallimet ndërmjet të kundërtave (*Ikhtilaaf tedaad*)
- Dallimet ndërmjet variacioneve (*Ikhtilaaf tenewwu*)

### 1. Dallimet ndërmjet variacioneve

Përkufizim: Këto janë dallime ku pikëpamjet nuk kundërshtojnë e as nuk përjashtojnë njëra-tjetrën.

Shembuj: Nganjëherë vetë Ligjvënësi na jep zgjedhje të ndryshme, si në ajetin në vijim ku flitet për shlyerjet për betimet:

“Shlyerje për këtë është të ushqyerit e dhjetë nevojtarëve me mesataren e asaj me çfarë ushqeni familjet tuaja, të veshurit e tyre apo lirimi i një robi. Kush nuk gjen (nevojtarë, apo s’ka mundësi), le të agjërojë tri ditë.” (el-Ma’ideh, 89)

Ka dhe të tjera dallime, siç janë format e ndryshme të ezanit dhe të ikametit, duatë ndryshme në fillim të namazit, etj. Kjo vlen edhe në rastin e grupeve dhe organizatave islamike, që kryejnë aktivitete të ndryshme, siç është daweti,

edukimi, reforma shoqërore, aktiviteti politik, etj. Këto dallime nuk janë aspak kundërshtuese; cilindo opion që ta zgjedhësh, është i pranueshëm.

### Urtësia në dallimet ndërmjet variacioneve

- Shfaqja e mëshirës së Allahut ﷻ, duke qenë se forca dhe zelli i njerëzve dallon
- Të bashkuarit e tonë si pjesë të ndryshme të një enigme, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën dhe s'mund ta zëvendësojnë njëra-tjetrën.

### Gabimet në këtë

- Çekuilibrimi: të qenët i preokupuar së tepërmi me aktivitetin tënd në dëm të të tjerëve
- Përbuzja e përpjekjeve të të tjerëve
- Partishmëria: kur besnikëria ndaj grupit konkurren me besnikërinë ndaj të gjithë muslimanëve

## 2. Dallimet ndërmjet të kundërtave

Përkufizim: Dallimet ku pikëpamjet bien në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Disa dijetarë kanë thënë se, nëse juristi arrin shkallën e *ixhtihadit*<sup>2</sup>, qëndrimet e tij do të jenë në rregull në çdo rast. Kjo meqë ai është i kualifikuar për të bërë *ixhtihad* dhe jep më të mirën e mundshme nga vetja.

Realiteti është se njëri nga qëndrimet duhet të jetë i gabuar. Në shikimin e Allahut ﷻ, një gjë s'mund të jetë edhe hallall, edhe haram. Pejgamberi ﷺ tha:

“Nëse gjykuesi merr vendimin sipas dijes që ka dhe e ka me vend (dmth përputhet me vendimin e Allahut dhe të pejgamberit ﷺ), ai do të ketë shpërblim të dyfishtë; nëse ai merr vendimin sipas dijes që ka dhe nuk e ka me vend (dmth nuk përputhet me vendimin e Allahut dhe të pejgamberit ﷺ), prapë do të shpërblehet.”<sup>3</sup>

Ky hadith liron *muxhtehidin*<sup>4</sup> nga gjynahu dhe i premtton shpërblim, por po ashtu shpreh qartazi mundësinë që ai të gabojë.

<sup>2</sup> *Ixhtihad*: Të ushtrosh gjykim personal në çështjet juridike (Bewley, Glossary of Islamic Terms, 134)

<sup>3</sup> El-Buhari, *es-Sahih*, hadithin 7352

<sup>4</sup> *Muxhtehid*: I kualifikuari për të bërë *ixhtihad* (Bewley, Glossary of Islamic Terms, 137)

Shembuj: Shumica e shembujve në fushën e fikhut janë të këtij lloji. Shumë shembuj do të përmenden, kur të diskutohen nivelet e këtyre dallimeve.

### **Urtësia në dallimet ndërmjet të kundërtave**

Allahu ﷻ na sprovon nëpërmjet këtyre dallimeve. Allahu ﷻ thotë:

“Ne i bëmë sprovë disa prej jush për të tjerët. A nuk do të duroni? Dhe Zoti yt sheh çdo gjë.” (el-Furkan, 20)

Gjërat që vihen në sprovë në këtë rast:

- i. A do të jetë besnikëria jonë ndaj gjërave të kësaj jete, apo ndaj Allahut ﷻ? Ka njerëz që përmbahen nga kundërshtimi i gjërave të gabuara nga frika e humbjes së lidhjeve me të tjerët. Për këtë shkak, shumë njerëz ngurrojnë t'i nënshtrohen Allahut ﷻ dhe ta pranojnë fenë e Tij.
- ii. A do t'i trajtojmë dallimet në mënyrën më të kënaqshme për Allahun ﷻ? Këto mënyra dallojnë varësisht nga lloji i dallimit, çka do të diskutohet më poshtë.
- iii. A do ta zgjedhim pozicionin që kënaq Allahun ﷻ, apo atë që na kënaq neve?

### **Gabimet në këtë**

Dështimi në cilindo nga këto prova.

## **2.1. Nivelet e dallimeve ndërmjet të kundërtave**

### **2.1.1. Dallimet mes feve**

Dallimi mes Islamit dhe feve të tjera, domethënë mospajtimi rreth njësimi të Allahut ﷻ dhe peygamberllëkut të Muhamedit ﷺ. Këtu po ashtu përfshihet dallimi nga sektet që janë konsideruar të dala nga Islami nga dijetarët muslimanë, ku bëjnë pjesë: Kadjanitë, Druzët, Alewitë, dhe Agakanët.

### **2.1.2. Dallimet ndërmjet sekteve të ndryshme muslimane**

Në veçanti, problemi te mospajtimi mes Sunive dhe Shi'itëve nuk qëndron te interpretimi i burimeve të përbashkëta, por te kontestimi i vetë burimeve. Përveç pajtimit rreth Kuranit, hadithet e transmetuara në Sunet nuk pranohen nga Shi'itët, dhe anasjelltas; përveç atëherë kur përdoren në debat për të provuar përshkrimin e tyre (Shi'it).

Diskutimi këtu duhet të përqendrohet në vlefshmërinë (legjitimitetin) e përshkrimeve kundërshtuese duke përdorur Kuranin dhe logjikën.

### 2.1.3. Dallimet përbrenda Ehlus-Sunetit

Termi *Ehlus-Suneh* këtu po përdoret në kuptimin e gjerë, për të përfshirë grupe të ndryshme të cilat pranojnë burimet e Ehlus-Sunetit, që janë Kurani, Suneti (siç është përmbledhur nga Ehlus-Suneti) dhe *Ixhma*.<sup>5</sup>

Dallimet ndërmjet Ehlus-Sunetit mund të jenë në çështjet e akides (besimit) dhe në ato të fikhut (praktikës). Këto dallime mund të ndahen në dy nivele:

#### i. Suneti karshi Bidatit dhe e Vërteta karshi Pavërtetësisë

Kjo ndodh atëherë kur metodologjia e ndjekur në nxjerrjen e një përfundimi është e gabuar, sepse nuk përfill metodën e duhur, të përdorur nga Paraardhësit e Drejtë (Selefët) në interpretimin e Shpalljes dhe në nxjerrjen e vendimeve nga ajo. Metoda e gabuar mund të çojë në formimin e koncepteve të gabuara, në devijime, dhe në bidate. Disa shembuj të kësaj janë:

Interpretimi ezoterik (që synohet të kuptohet vetëm nga një grup me dije të specializuar) i emrave dhe i cilësive të Allahut ﷻ. Të mohosh cilësitë që Allahu ﷻ ia atribuoi vetes së Tij dhe pejgamberi ﷺ i atribuoi Atij është bidat. Fakti se disa nga dijetarët tanë më të mëdhenj ranë në këtë gabim të madh nuk e bën më të vogël këtë gabim. Këta dijetarë do të falen, meqë ishte *ixhtihadi* i tyre dhe përpjekja e skajshme për të gjetur të vërtetën që i bëri të binin në këtë gabim.

Bidatet e ndryshme në besim dhe në praktikë, siç është pohimi se pejgamberi ﷺ përbëhet nga drita, të vdekurit mund t'u ndihmojnë atyre që u luten, ewlijatë janë më të mirë se pejgamberët, etj. Në praktikë ka shumë bidate dhe devijime që nuk kanë bazë. Këtu hyjnë shumë bidate që kanë të bëjnë me varrosje, siç është ngritja e faltoreve mbi varr, pagimi i recituesve të Kuranit për t'i kënduar Kuran të vdekurit, rëndimi i familjes së të vdekurit me mikpritjen dhe të ushqyerit e një turme të madhe njerëzish, kurse suneti është që të afërmit apo fqinjët t'i përgatitin ushqimin familjes së të vdekurit.

Këtu vlen të theksohet se gabimet në detajet e akides janë sikurse gabimet në fikh, kur kemi të bëjmë me trajtimin e *muxhtehidit* i cili bie në këto gabime. Shejh Ibn Tejmije qartazi thotë se s'ka bazë për dallimin

<sup>5</sup> *Ixhma*: Konsensusi i dijetarëve muslimanë (Bewley, Glossary of Islamic Terms, 10)

mes këtyre dy fushave (Bazat e akides janë të ndryshme nga detajet e akides; ato janë aq të qarta sa s'ka justifikime për gabimet në to)

ii. Saktë karshi Pasaktë

Kjo ndodh atëherë kur dijetarët kanë metodën e duhur të interpretimit të Shpalljes, megjithatë arrijnë në përfundime të ndryshme.

Të gjitha shtresat e mësipërme të dallimeve, janë të pajustificueshme. Kjo shtresa e fundit (Saktë karshi Pasaktë) ndahet në dallimet e justifikueshme dhe në ato të pajustificueshme. Për të qenë i justifikueshëm, dallimi duhet të përmbushë kushtet në vijim:

a. Dallimi të mos jetë në parimet apo bazat e besimit dhe të praktikës.

Esh-Shatibi tha:

“Në vlerësimin e dijetarëve eruditë, gjejmë pohimin se pajtimi rreth besimeve është i paarritshëm, meqë çështjet spekulative gjithmonë tërheqin diskutim. Mirëpo, kjo vlen për detajet (e besimit), jo për bazat.”<sup>6</sup>

b. Dallimet nuk bën të bien në kundërshtim me:

- ✓ Shpalljen e verifikuar, të pa shfuqizuar
- ✓ Konsensusin e qartë, të konfirmuar
- ✓ Aksiomat mendore
- ✓ Gjërat e perceptueshme nga shqisat

Ibn Tejmije tha:

“Kushdo që nga një pozicion i pajustificueshëm bie në kundërshtim me ajetet e qarta të Kuranit dhe me Sunetin e vërtetuar apo me atë rreth së cilës u pajtuan Selefët e umetit, ai do të trajtohet si ithtarët e bidateve.”<sup>7</sup>

c. Të ketë mbështetje në Shpalljen

d. Të dalë nga muxhtehidë të mëdhenj, meqë njerëzit e rëndomtë nuk janë kompetentë për të nxjerrë vendime nga Shpallja.

<sup>6</sup> Esh-Shatibi, *Kitaab el-l'tisaam*, vëll.3, 93

<sup>7</sup> Ibn Tejmije, *Mexhmu'at el-Fetaawaa*, vëll.224, 172

- e. Të mos jetë i braktisur nga umeti. Për shembull, lënia e qëndrimit që i atribuohet Ibn Abasit ؓ lidhur me martesën e përkohshme i shton më tej grumbullit të provave që dëshmojnë se ky qëndrim nuk është i vlefshëm.

Shembuj të dallimeve të pajustificueshme, të bazuara në metodën e duhur<sup>8</sup>:

Para se të vazhdojmë, është me rëndësi të kihet parasysh se jo të gjitha dallimet janë të pranueshme. Dallimet e pranueshme duhet patjetër të kenë një bazë në Kuran dhe në Sunet, apo të na jenë përcjellë nga Selefët. Kësodore, dijetari malikij, Ebul-Hasen ibn el-Hisaar, tha:

“Jo çdo mospajtim (*khilaaʿ*) është i vlefshëm. Dallimi i vlefshëm është vetëm ai që ka një bazë të shëndoshë.”<sup>9</sup>

Si shembuj të dallimeve të pajustificueshme, që nuk bazohen në metodën e duhur, kemi:

- Lejimin e marrëdhënieve seksuale në anus (mes burrit dhe gruas) që i atribuohet Ibn Umerit
- Lejimin e sasisë së pakët të pijeve dehëse, të bëra nga substanca të tjera veç rrushit dhe hurmave.
- Lejimi i kamatës shtuese (*Ribaa el-Fadl*)

Do të gjesh se, dijetarët që mbajtën këto qëndrime, kanë ndjekur metodë të duhur të (deduksionit) nxjerrjes së vendimeve, por nuk kanë qenë të informuar për të gjitha provat ekzistuese. Pra, nganjëherë gabimi mund të vijë si rezultat i një zbatimi të gabuar të një parimi të vlefshëm në nxjerrjen e vendimit.

Shembuj të dallimeve të justifikueshme:

Në akide:

- Të parët e Zotit nga pejgamberi ؑ
- Shkalla e pagabueshmërisë së të Dërguarve. Domethënë, a mund të kenë bërë ata gjynahe të mëdha?
- Pejgamberllëku i Hidrit

<sup>8</sup> Domethënë, rasti kur metoda është e saktë, por vendimi është i gabuar.

<sup>9</sup> Es-Sujuti, *el-Ittikaan fi Uluum*,

- d. Dalja nga Islami nëpërmjet njërës nga shtyllat e tij, sidomos namazi.
- e. Çka u krijua së pari: Froni, apo Lapsi?

Dikush mund të befasohet se ka dallime të justifikueshme në çështjet e akides. Kjo s'duhet të jetë një befasi, sepse, ndonëse bazat e akides sonë janë çështje konsensusi mes muslimanëve Suni, pikëpamjet e detajuara u nënshtrohen mënyrave të ndryshme të të kuptuarit, si në rastin e fikhut, edhe pse ka më pak dallime në akide. Për më shumë, fakti se Sahabët dalluan rreth disa çështjeve (detaje) të akides nuk mund të mohohet.

Në fikh (praktikë):

- a. Obligimi i shpëlarjes së gojës dhe hundës në abdes
- b. Pozita e vendosjes së duarve pas rukusë
- c. Obligimi i nikabit për gratë
- d. Namazet sunet të lejuara në kohët kur namazet vullnetare janë të ndaluara
- e. Mishi i therur nga lthtarët e Librit pa përmendjen e Allahut.

Ndarja e fundit e dallimeve hyn në dallimet e justifikueshme: te disa, e kundërta është e fortë; te të tjera, është e dobët.

Shembuj të dallimeve të mëdha, ku pikëpamjet e kundërta u afrohen për nga forca:

- f. Trashëgimia e vëllezërve në prani të gjyshit
- g. Rënia në sexhde me duar apo me gjunjë së pari
- h. Shikimet e njësuara apo veç e veç të hënës
- i. Obligimi i zekatit në stoli
- j. Obligimi i namazit me xhemat
- k. Recitimi i el-Fatiha për atë që fal namaz mbrapa imamit

Dallimet e justifikueshme gjatë kohës së peygamberit ﷺ:



Ka shembuj dallimi që dalin nga dallimi në interpretime nga koha e peygamberit ﷺ. Domethënë, ai ﷺ justifikonte këto dallime. Në vijim kemi një shembull të kësaj:

“Tregoi Ibn Umer: Kur peygamberi ﷺ u kthye nga beteja e Ahzabit, na tha: ‘Të mos falni namazin e ikindisë veçse te Beni Kurejdha.’ Pasi hyri koha e namazit të ikindisë, disa prej tyre vendosën të mos falnin ikindinë pa mbërritur te Beni Kurejdha, duke u arsyetuar se qëllimi i peygamberit nuk ishte ashtu siç e kishin kuptuar pala tjetër. Kur kjo iu kumtua peygamberit ﷺ, ai nuk fajësoi asnjërën palë.”<sup>10</sup>

Shembuj të dallimeve të dobëta:

- a. Dhënia e zekatit për çdo qëllim të mirë
- b. Lejimi i muzikës<sup>11</sup>. Disa mund ta konsiderojnë këtë dallim si të pa justifikueshëm, mirëpo, pavarësisht dobësisë së qëndrimit se muzika është e lejuar, kjo hyn brenda shtrirjes së dallimeve të justifikueshme. Diskutimi mbetet akademik, ndërsa pikëpamjet e atyre që e lejojnë, nuk janë krejtësisht të pabaza.
- c. Ndalimi i unazave si stoli.
- d. Lejimi i vizatimeve dy-dimensionale
- e. Lejimi i shitjes së qenve
- f. Në akide, shuarja e Zjarrit të xhehenemit konsiderohet si qëndrim tejet i dobët.

Një tjetër ndarje e dallimeve e llojit saktë-karshi-pasaktë varet nga nivel në të cilin ndodh, kur kemi të bëjmë me vendimin mbi të. Këtu vendimi ndërlihet me interpretimin e tekstit apo zbatimin e parimeve shariatike karshi realiteteve të ndryshme, ku të kuptuarit e realitetit dhe të parimit a të vendimit më të përshtatshëm dallon nga një muxhtehid te tjetri.

Shumë nga dallimet mes aktivistëve muslimanë janë rezultat i të kuptuarit të ndryshëm që ata kanë për realitetet që gjykohen.

#### 2.1.4. Disa dobi të dallimeve të pranueshme

<sup>10</sup> El-Buhari, *es-Sahih*, hadith 946

<sup>11</sup> Sigurisht se kjo nuk përfshin muzikën Rok dhe Rep të ditëve tona. Po ashtu kjo s'ka të bëjë me këngë epshore dhe të pandershme. Dallimi i mendimit ka të bëjë vetëm me përdorimin e muzikës të shoqëruar me recitimin e vargjeve poetike të lejueshme.

Ibn Tejmije tha:

“Konsensusi i tyre (dijetarëve) është një provë përfundimtare, ndërsa dallimi mes tyre është një mëshirë e madhe.”<sup>12</sup>

- Siç u përmend më lart, nëse dallimet kufizohen brenda kufijve përkatës dhe njerëzit trajtohen për të respektuar etikën dhe normat e shprehjes dhe menaxhimit të dallimeve, ka disa përparësi pozitive që mund të dalin nga kjo.
- Nëse qëllimet janë të sqarta, dallimet në mendime mund të sjellin një vetëdije më të madhe për aspekte të ndryshme dhe për interpretime të provave. Një dallim i këtillë mund të prodhojë një vitalitet dhe pjellori idesh. Ka gjasa që ky proces të qesë në shesh një sërë hipotezash në trajtimin e çështjeve të caktuara.
- Një proces i këtillë ka gjasa të parashtrojë një sërë zgjidhjesh për trajtimin e një situate të caktuar, në mënyrë që të mund të zgjidhet më e përshtatshme. Kjo është në përputhje me natyrën lehtësuese të fesë Islame, që ka konsideratë për realitetin e jetëve të njerëzve.
- Këto dhe të tjera dobi mund të realizohen, nëse dallimet mbeten brenda kufijve dhe normave etike që rregullojnë ato. Nëse këta kufij e norma nuk respektohen, dallimet shumë lehtë mund të keqësohen deri në grindje dhe përçarje, duke kaluar kështu në një forcë negative, që do të prodhonte edhe më shumë mosmarrëveshje në umetin musliman. Kësisoj dallimet në mendime mund të ndryshojnë nga një forcë konstruktive në një element shkatërrimi.

### 3. Shkaqet e dallimeve

#### 3.1 Urtësia hyjnore

Rrënja e cilësdo dukuri është vullneti i Allahut ﷻ. Kurrjë nuk ndodh në këtë univers pa vullnetin e Tij. Shumë çështje që Ai caktoi, nuk pëlqehen nga Ai që krijesat t'i bëjnë, megjithatë, për ndonjë arsye, vullneti i Tij që ato të ndodhin. Edhe pse ne kurrë s'do të mundim ta kapim urtësinë e Tij, duhet shikuar për ta gjetur në të gjitha vendimet dhe urdhrat e Tij. Allahu ﷻ thotë:

“Ne i bëmë sprovë disa prej jush për të tjerët. A nuk do të duroni? Dhe Zoti yt sheh çdo gjë.” (el-Furkan, 20)

<sup>12</sup> Ibn Tejmije, *Mexhmu'at el-Fetaawaa*, vëll.30, 80

Nëse tërë jeta është një test, atëherë as marrëdhëniet tona nuk përjashtohen nga kjo. Ne, pra, jemi duke u testuar nga Allahu ﷻ nëpërmjet njëri-tjetrit.

Ai gjithashtu caktoi që dallimet apo mospajtimet të mos përfundojnë në këtë jetë; për shumëçka e vërteta do të manifestohet krejtësisht vetëm në jetën e përtejme.

“Njerëzimi që një komunitet (të bashkuar në fe), pastaj u dalluan. Po të mos ishte fjala paraprijëse nga Zoti yt, do të merrej vendimi (menjëherë) për atë që ata nuk pajtohen.” (Merjem, 19)

### 3.2 Natyra njerëzore

- Dështim në qëllim (nijet) dhe sjellje
- Dështim në të kuptuar dhe në gjykim
- Përzierje e këtyre dyjave

#### 3.2.1. Dështim në qëllim (nijet) dhe sjellje

Dështimi në qëllimi i referohet situatës kur njerëzit e dinë se pozicioni i tyre është i gabuar, megjithatë vazhdojnë ta mbrojnë atë. Kjo mund të jetë për shkak të veseve të ndryshme, si: arroganca, tekat, gara për kënaqësi të kësaj jete, murrja, tirania e sadizmi, etj. Allahu ﷻ thotë:

“Nuk dalluan rreth Shpalljes veçse ata që u qe dhënë ajo dhe atë pasi u mbërritën prova të qarta, për shkak të xhelozisë/armiqësisë që kishin ndërmjet vete.” (el-Bekare, 213)

Kësaj kategorie i shtohet edhe dështimi në sjellje, që ndodh kur të paditurit flasin për atë që s’dinë, pa pasur konsideratë për seriozitetin e çështjes. Sot, injoranca për Islamin është një ndër shkaqet kryesore të dallimit ndërmjet muslimanëve. Mendja muslimane sulmohet pandërprerë së brendshmi e së jashtmi, ndërsa vlerat dhe mësimet e Islamit janë zbehur në mendjet dhe zemrat e muslimanëve. I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

“Allahu nuk ua merr dijen njerëzve duke e nxjerr nga zemrat e tyre, por ua merr me vdekjen e të diturve, derisa të mos mbetet asnjë i ditur dhe njerëzit t’i marrin për udhëheqës të paditurit që japin fetva pa dije. Kështu, ata humbin vetët e tyre dhe i devijojnë të tjerët.”<sup>13</sup>

#### 3.2.2. Dështim në të kuptuar dhe në gjykim

<sup>13</sup> El-Buhari, *es-Sahih*, hadithi 100

Dështimi në gjykim ndodh atëherë kur kërkuesit e dijes arrijnë në përfundime të ndryshme, për shkak të pikëpamjeve të ndryshme apo të kuptuarit të ndryshëm, apo dhe për shkak të çështjes së ndërlikuar.

Shumica dërrmuese e dallimeve kundërshtuese që ndodhin mes dijetarëve tanë të mëdhenj kanë qenë rezultat i dështimit në gjykim, jo në qëllim (nijet). Tri shkaqet kryesore të këtyre dallimeve janë:

- i. Mospajtimi rreth vendosjes së provës (A ka thënë Shpallja këtë?)
- ii. Mospajtimi rreth interpretimit të provave (A kishte Shpallja për qëllim këtë?)
- iii. Mospajtimi rreth bashkërenditjes së provave të ndryshme (Por Shpallja po ashtu ka thënë kështu e kështu!)

### 3.1.2.1. Vendosja e provave

- (Mos) Pasja e transmetimeve pas vdekjes së peygamberit ﷺ

Bile edhe Sahabët nuk përfshinë tërë dijen që peygamberi ﷺ përcolli. Ebu Hurejre ؓ, transmetuesi më i madh i haditheve, mbante qëndrimin se, kush zgjohet nga gjumi i bërë *xhunub*<sup>14</sup>, nuk mund të vazhdojë agjërimin. Mirëpo, Aisha ؓ dhe Umm Selemeah ؓ thanë, siç shënuan Buhari dhe Muslim:

“Peygamberi zgjohej *xhunub* në mëngjes – jo si rezultat i ndonjë ëndrre – dhe agjëronte.”

Kur Ebu Hurejres i mbërriti çfarë kishin thënë ato, ai pa vonuar pranoi duke thënë:

“Ato e dinë më mirë.”<sup>15</sup>

- Vërtetësia e transmetimeve

Ebu Daud shënoi një hadith të dobët nga Aisha ؓ, ku peygamberi ﷺ tha:

<sup>14</sup> Xhunubllëk: papastërtia e madhe rituale, që kërkon bërjen e pastrimit të plotë të trupit apo *guslit* (Bewley, Glossary of Islamic Terms, 12)

<sup>15</sup> Muslim bin Haxhaaxh, *es-Sahih*, hadithi 174

“Oj Esma, kur një femër arrin moshën e menstruacioneve, nuk është më vend që të shihet diçka te ajo, përveç kësaj dhe kësaj (dhe bëri me gjest nga fytyra dhe duart e tij).”

Ebu Daud tha: “Ky transmetim është *mursel*. Khaalid ibn Dureik nuk takoi Aishen (veç kësaj, Sa’id ibn Beshir nuk është i fortë [në transmetimin e haditheve]).”<sup>16</sup>

Vërtetësia e këtij transmetimi është e diskutueshme, prandaj dhe dijetarët që konsiderojnë se nikabi është obligim, nuk marrin parasysh këtë transmetim për sa kohë që besojnë se s’është i verifikuar.

### 3.1.2.2. Interpretimi i provave

- Arsyet gjuhësore

Një shembull i kësaj është se fjala *kur’* në Kuran, që i referohet periudhës pritëse për gratë pas shklorëzimit, mund të interpretohet gjuhësisht si periudha e menstruacioneve apo si periudha mes dy menstruacioneve.

- Dallimet personale

Kjo nuk vërehet vetëm në çështjet e fesë, po në të gjitha çështjet, meqë njerëzit kanë kapacitete të ndryshme mendore dhe veçori personale e kulturore.

- Dallime në *Usuul* (Baza)

Kjo përbën një katalizator të madh në dallimet në fikh. Për shembull, Imam Maliku i jep përparësi traditës së banorëve të Medines ndaj transmetimeve të vetme (*ehaad*).<sup>17</sup>

### 3.1.2.3. Bashkërenditja mes provave të ndryshme

Bashkërenditja mes provave kundërshtuese në dukje, siç është falja e namazit përshëndetës (*tehiyatul-mesxhid*) me rastin e hyrjes në xhami pas ikindisë, është një shembull i mirë i këtij lloji të dallimit, duke qenë se njëri transmetim ndalon nga falja e namazit pas hyrjes së kohës së

<sup>16</sup> Es-Sexhistaani, Ebu Daud, *es-Sunen*, hadithi 4104

<sup>17</sup> Transmetim *ehaad*: një hadith i izoluar; një informatë e transmetuar nëpërmjet një zinxhiri të vetëm apo nga një burim i vetëm.” (Bewley, Glossary of Islamic Terms, 97)

ikindisë, kurse tjetri transmetim urdhëron për faljen e dy rekateve para uljes në xhami.

#### 3.1.2.4. Një përzierje e qëllimit dhe e gjykimit

Shpeshherë një mospajtim ndodh për shkak të një arsyeje dytësore, por, për shkak të injorancës, ai vjen duke u rritur apo vazhdon për shkak të arsyes parësore. Personi fillimisht mund të dështojë të kuptojë gabimin në logjikën e vet dhe, rrjedhimisht, të zhvillojë një fanatizëm për pozicionin e vet dhe t'i injorojë treguesit e gabimit të tij. Gabimi i tij fillestar mund të falet, por fanatizmi i mëpasshëm a refuzimi i provave nga ana e tij është gjynah.

### 4. Vendimi mbi mospajtimin

Vendimi mbi mbajtjen e një qëndrimi të ndryshëm nga ajo çfarë Allahu vërtet ka pasur si qëllim ndryshon varësisht nga shkak i marrjes së një qëndrimi të tillë.

Të refuzosh burimet e fesë ashtu siç na janë përcjellë dhe të mos besosh fare në tërë Shpalljen e të mos nënshtrohesh – qoftë dhe vetëm me zemër – ndaj të gjithë urdhrave të Allahut, është një akt mosbesimi.

Refuzimi i burimeve të fesë ashtu siç na janë përcjellë nga gjenerata e parë e besimtarëve dhe përzgjedhja e vetëm asaj që përputhet me pikëpamjet tona, është një bidat i dënueshëm, që mund të arrijë shkallën e mosbesimit të plotë, nëse ndërthen refuzim të ndonjë ajeti Kuranor apo një suneti *mutewaatir*.<sup>18</sup> Diskreditimi i Sahabëve të peygamberit ﷺ apo i disave prej tyre çon pashmangshëm në kryerjen e këtij gjynahu të rëndë.

Shpikja në fe dhe ndjekja e një metode të interpretimit nga burime të ndryshme nga ato që janë miratuar nga Paraardhësit e drejtë (Selefët) po ashtu është devijim që meriton hidhërimin e Allahut ﷻ.

Të lejosh që arroganca, tekat, kokëfortësia a besnikëritë fanatike që ke ndaj të tjerëve të të ndalojnë nga pranimi i së vërtetës që përputhet me Librin e Allahut dhe me Sunetin e të Dërguarit të Tij si dhe nga ndjekja e vullnetit hyjnor, është një akt shkeljeje i dënueshëm, që meriton ndëshkimin.

Të flasësh për atë që nuk ke dije është e ndaluar.

Gabimi i një muxhtehidi të kualifikuar, për shkak të një dështimi në gjykim, është i falshëm nga Allahu ﷻ. Për më shumë, muxhtehidi që nuk bën ndonjë shkelje

<sup>18</sup> *Mutewaatir*. Gjuhësisht kjo do të thotë përsëritje e vazhdueshme; teknikisht kjo do të thotë një transmetim me anë të një numri të madh njerëzish në të gjitha fazat e zinxhirit të transmetimit (*isnad*), duke përjashtuar kështu mundësinë e marrëveshjes rreth një gënjeshtre.

dhe nuk ndjek tekat, do të shpërblehet për përpjekjet e bëra në studimin e çështjes lidhur me të cilën gabon.

E njëjta gjë vlen për një ndjekës, nëse ai bën çfarë është e mundur në gjetjen e fetvasë së qëlluar duke kërkuar atë nga një muxhtehid i dijshtëm dhe i besueshëm, duke shqyrtuar provat e tij aq sa ka mundësi.

#### **4.1. Vendimi mbi trajtimin e pikëpamjeve të ndryshme**

Ndërsa mospajtimi mund të mos pushojë së ekzistuari, përçarja nuk është e pëlqyeshme; madje nganjëherë është një e ligë që çon në shumë të këqija të tjera. Atëherë, a duhet t'i mënjanohet dallimet me anë të kompromiseve? Cilat janë dallimet që duhet të mbeten dhe cilat janë dallimet që mund të mënjanohen dhe si ta bëjmë këtë?

- i. Ka dallime që duhet mbetur si një kusht besimi (imani)
- ii. Ka dallime që duhet mbetur për të mbrojtur pastërtinë e fesë.
- iii. Ka dallime që duhet dënuar, meqë janë gabime të qarta
- iv. Ka dallime që duhet toleruar dhe mënjanuar me anë të këshillimit të mirë
- v. Ka dallime që nuk kanë nevojë për mënjanim apo pajtim rreth tyre; ato kanë nevojë për plotësim

Rregullat e detajuara lidhur me qëndrimin e duhur karshi pikëpamjeve të ndryshme do të diskutohen në kapitullin e radhës.

#### **5. Menaxhimi i dallimeve**

Dallimi për menaxhimin e të cilit po bëhet fjalë këtu është dallimi kundërshtues, jo ai i variacioneve. Për sa i përket dallimeve në variacione, përmendëm gabimet në rastin e tyre, ndërsa menaxhimi i tyre realizohet duke iu shmangur këtyre gabimeve.

Ajo çfarë mendohet me menaxhim këtu është parandalimi dhe trajtimi i dukurisë së dallimit kundërshtues. Kjo s'do të thotë se synimi ynë është zhdukja e plotë e këtij lloji të dallimit, meqë kjo është e pamundshme; ajo çfarë do të diskutohet këtu është mënyra e arritjes së më të mirës në orvatjen për ta ngushtuar shtrirjen e mospajtimit dhe mënyra e trajtimit të pasojave që dalin nga kjo.

Çfarëdo e folme për menaxhimin e dallimit, duhet të përfill llojet dhe shkaqet e dallimit. Sepse të gjitha dallimet nuk janë njësoj; nganjëherë s'ka vend për kompromis, herëve të tjera ka vend për këtë. Në rastin kur ka vend për kompromis, qëllimi i ruajtjes së unitetit të komunitetit duhet të jetë më i rëndësishëm sesa përkushtimi ndaj pikëpamjes personale. Po ashtu menaxhimi i dallimit apo mospajtimit ndryshon në varës nga ajo se a ka të bëjë me dështimin e qëllimit apo të gjykimit. Duhet të angazhohemi që t'i jepet shtysë dijes autentike dhe të kuptuarit autentik për ta kufizuar shtrirjen e mospajtimit që del nga dështimi në gjykim. Për sa i përket dallimit që del nga dështimi në qëllim, këtu duhet bërë shumë më shumë punë në pastrimin e zemrave dhe mënjanimin e shkaqeve të këtij dështimi.

## 5.1. Rekomandime të përgjithshme

### 5.1.2. Pajtohu me faktin se do të ketë dallime, por puno për të arritur unitetin

Nëse Allahu ﷻ caktoi që të ketë mospajtime, a duhet t'i dorëzohemi kësaj si një fati të pashmangshëm? Jo. Ne jemi urdhëruar të mundohemi për unitet. Allahu ﷻ thotë:

“Mos u bëni si ata që u përçanë dhe u dalluan pasi u mbërritën provat e qarta.” (Aal Imran, 105)

### 5.1.3. Mbahuni për Litarin e Allahut: Kuranin dhe Sunetin

Allahu ﷻ thotë:

“Mbahuni fort për Litarin e Allahut të gjithë së bashku dhe mos u përçani.” (Aal Imran, 103)

### 5.1.4. Kundërshtimi i Sunetit duke përdorur pikëpamje të dijetarëve nuk bën pjesë në dallimin e ligjshëm të mendimeve

I Dërguari i Allahut ﷺ na instrukttoi ta kërkojmë unitetin duke u mbajtur për Librin e Allahut dhe për Sunetin e Tij. Pejgamberi ﷺ tha:

“Sigurisht, kushdo prej jush që do të jetojë (pas meje), do të shohë dallime të mëdha. Ruhuni nga shpikjet në fe, se vërtet ato ju humbin.



Kushdo që mbërrin ta shohë këtë, le të kapet fort për Sunetin tim dhe për Sunetin e kalifëve të udhëzuar drejt; le ta shtrëngojë me dhëmbë.”<sup>19</sup>

Imam Shafiu tha:

“Muslimanët janë të një mendjeje për atë se, atij që i bëhet i qartë Suneti i të Dërguarit të Allahut, i bëhet e ndaluar ta lërë atë për thënien e kujtdo tjetër, kushdo qoftë ai.”<sup>20</sup>

Imam Shafiu po ashtu tha:

“Dije është ajo, që përcillet nëpërmjet zinxhirëve të transmetuesve ... të gjitha të tjerat (të ashtuquajtura dije) janë pëshpëritje të shejtanëve.”<sup>21</sup>

#### 5.1.5. Merr Paraardhësit e drejtë, sidomos gjeneratën e parë, si standard dhe vlerë krahasuese

Bukuria e Islamit është se ai u jetua nga një gjeneratë model, duke ofruar kështu më shumë udhëzim për mënyrën e kapjes për Kuranin dhe Sunetin. Pejgamberi ﷺ tha:

“Çifutët u ndanë në 71 a 72 grupe. Edhe të krishterët ngjashëm me këtë. Umeti im do të ndahet në 73 grupe.”<sup>22</sup>

I Dërguari i Allahut ﷺ po ashtu tha në hadithin e mësipërm:

“... kapu për Sunetin tim dhe për sunetin e kalifëve të udhëzuar drejt ...”

Xhabir ؓ tha:

“I Dërguari i Allahut ishte mes nesh ndërsa po i zbriste Kurani dhe ai e dinte interpretimin e tij. Kështu, ne bënim atë çfarë bënte ai.”<sup>23</sup>

#### 5.1.6. Kërko dije dhe shpërndaje atë

Kjo na ndihmon kundër dështimeve të shumta në gjykim. Të dish pikat e konsensusit dhe të dallimeve është thelbësore në menaxhimin e duhur të dallimeve apo mospajttimeve.

<sup>19</sup> Et-Tirmidhi, Ebu Isa, *el-Xhami*, hadithi 2676

<sup>20</sup> Ibn el-Kajjim, *l'lam el-Muwekki'in an Rabb el-Alemin*, vëll.1, 6

<sup>21</sup> Esh-Shafi dhe Abdul-Musataawi, *Diwaan el-Imam esh-Shaafi'i*, 118

<sup>22</sup> Et-Tirmidhi, Ebu Isa, *el-Xhaami*, hadithi 2640

<sup>23</sup> Es-Sixhistani, Ebu Daud, *es-Sunen*, hadithi 1905

Individët duhet të mësojnë dhe ta promovojnë dijen. Organizatat islame duhet të zhvillojnë një kulturë të kërkimit dhe të nderimit të dijes e të poseduesve të saj. Diskutimi akademik duhet të inkurajohet për ta ruajtur vazhdimësinë e suksesit dhe pjellorinë intelektuale. Përfshirja e ekspertëve të fushave të ndryshme të dijes, si: mjekësi, menaxhment, kimi, politikë, ekonomi, etj, është jetike për rëndësinë e diskursit islamik dhe për zbatimin e mësimëve islame.

#### 5.1.7. Pastro zemrën nga të gjitha të këqijat

- Mendjelehtësia
- Ndjekja verbazi dhe fanatizmi sektar

Umer ibn Abdul-Azizi tha:

“Dija nuk zhduket, përveç atëherë kur mbahet sekret.”<sup>24</sup>

Ai po ashtu tha:

“Kur të shohësh grupe njerëzish të diskutojnë fshehurazi rreth çështjeve të fesë, në përjashtim të publikut, ta dish se ata janë shpikës në fe (bidatçinj).”<sup>25</sup>

- Endja nëpër dijetarë për të gjetur fetvanë e pëlqyer e bën personin gjynahqar

Sulejman et-Tejmi tha:

“Nëse do të merrje pikëpamjet e buta të çdo dijetari, në ty do të grumbullohej çdo e keqe.”<sup>26</sup>

Allahu ﷻ thotë:

“A nuk ishte që, sa herë ju vinte një peygamber nga Zoti me diçka që ju s’e pëlqenit, ju tregoheshit arrogantë dhe disa prej tyre i përgënjeshtonit, disa i vritnit.”<sup>27</sup> (el-Bekare, 87)

<sup>24</sup> El-Buhari, *es-Sahih*, vëll.1, 115

<sup>25</sup> El-Lalekaa'i dhe el-Ghaamdi, *Sherh Usul l'tikad Ahlus-Sunneh wel-Xhem'a min el-Kitab wel-Sunneh we l'xhmaa es-Sahaabah wet-Taabi'iin we men Ba'dahum*, 153.

<sup>26</sup> Ibn Abdul-Berr, *Xhaami Bejaan el-Ilm we Fadlihi*, vëll.2, 927, nr.1766

“Atëherë, mos ndiqni qejfet tuaja e t’i shmangeni drejtësisë.” (en-Nisa, 135)

#### 5.1.8. Ruaj akiden dhe bazat e fesë

Është me rëndësi që të ruajmë pastërtinë e akidesë sonë. Gjithmonë është e rekomandueshme të marrësh një qëndrim më të fortë lidhur me dallimet në akide karshi atyre që kanë të bëjnë me praktikën (fikhun). Këtu më duhet të shtoj faktin se mund të ketë dallime të justifikueshme për çështje të akides, siç është ajo që ndodhi mes Aishes رضي الله عنها dhe Ibn Abbasit رضي الله عنه lidhur me çështjen e të parit e Allahut nga peygamberi صلى الله عليه وسلم. Ndryshe nga kjo, shumë nga dallimet në fikh mund të jenë të pajustificueshme. Ebu Bekr رضي الله عنه kryesisht luftoi kundra atyre që refuzuan ta jepnin zekatin.

#### 5.1.9. Njih pozicionin dhe nivelin tënd midis njerëzve të dijes, publikut, dhe pozicionit të tjerëve

- Nuk është e lejueshme për një muxhtehid të imitojë një muxhtehid tjetër që ka pikëpamje të ndryshme nga ajo çfarë *ixhtihadi* i tij e ka bërë të besojë.<sup>28</sup>
- Njerëzit kanë rënë dakord se personi që ndjek verbazi (*mukallid*) nuk llogaritet njeri i dijes, se të kesh dije nënkupton ta njohësh të vërtetën së bashku me provat e saja.<sup>29</sup>
- Një *mukallid* nuk bën ta qortojë një *mukallid* tjetër, përveç në çështjet ku ka konsensus mes dijetarëve; përndryshe ata mund të këmbejnë këshilla lidhur me qëndrimin më të saktë (të fortë) duke iu referuar analizave të qëndrimeve të ndryshme nga ana e muxhtehidëve.
- Lidhur me dijetarët tanë që mbajnë qëndrime të gabuara
  - i. Gabimet që dalin nga *ixhtihadi*, asnjëherë nuk bën të rezultojnë në përflitje (diskreditim), kur vijnë nga ata që njihen për virtyte dhe dije.
  - ii. Dijetarët e Sunetit dhe mbrojtësit e devijimit nuk bën të konsiderohen të barabartë. Askujt nuk bën t’i lejohet të dhunojë integritetin e dijetarëve të Sunetit.

<sup>28</sup> El-Amidi, Ebu el-Hasen Ali, *el-Ahkam fi Usul el-Ahkam*, vëll.4, 247

<sup>29</sup> Ibn el-Kajjim dhe es-Selman, *l’laam el-Muwekki’in an Rabb el-Alemin*, vëll.2, 11

- iii. Lidhur me Imamët tonë, edhe-Dhehebi tha: “Kur uji arrin dy *kul’la* (sasi e caktuar), nuk bëhet i ndotur.”
- iv. Kjo nuk nënkupton heshtjen/miratimin tonë karshi gabimeve të tyre.

Ali ؑ tha: “Sigurisht se e vërteta nuk përcaktohet nga personat që e përfaqësojnë. Mëso të vërtetën që të dish se kush vërtet e përfaqëson atë (të vërtetën).”<sup>30</sup> Prandaj, nuk është më vend të thuhet për një qëndrim se është i saktë vetëm ngaqë një imam i caktuar e mban atë.

#### **5.1.10. Ruaj vëllazërinë mes muslimanëve. Kur të shohësh një musliman të sinqertë të bëjë ndonjë padrejtësi, dëno atë, por dhe mos harro të gjitha të mirat që ai bën**

Të gjithë ne dimë çfarë i tha peygamberi ﷺ Ebu Dherrit ؑ:

“Vërtet te ti ende ka cilësi të injorancës para-islamike.”<sup>31</sup>

E, kush qe Ebu Dherr? Peygamberi ﷺ na tregon:

“Askush mbi faqen e dheut a nën qiell nuk është më i vërtetë në të folur sesa Ebu Dherr.”<sup>32</sup>

#### **5.1.11. Ji real**

Ki parasysht dallimet mes njerëzve. Njerëzit dallojnë në potencialin që kanë për të bërë punën si duhet. Shkallëzimi në reformë është mënyra si Islami trajton dobësitë njerëzore dhe dallimet në potencial.

#### **5.1.12. Shmangu nga retorika**

Ka dy mënyra për të përcaktuar retorikën:

- i. Shtjellim bindës i provave për të treguar cili vendim juridik është më i saktë
- ii. Mënyrë e të folurit, që i mundëson personit të mbajë një pozicion, pavarësisht sa i pavend është

<sup>30</sup> Ibn el-Xhewzi, *Telbis Iblis*, 483

<sup>31</sup> El-Buhari, *es-Sahî*, hadithi 30

<sup>32</sup> Ibn Maxheh, Muhamed bin Jezid, *es-Sunen*, hadithi 156

Lloji i dytë është i lig dhe duhet patjetër t'i shmangemi. Ebu Umaameh përcjell se i Dërguari i Allahut ﷺ tha:

“I garantoj një vendbanim në periferi të xhenetit atij që përmbahet nga argumentimi, edhe nëse e ka me vend; një vendbanim midis xhenetit atij që përmbahet nga rrena, edhe kur bën shaka; dhe një vendbanim në pjesën më të lartë të xhenetit atij që ka sjellje të moralshme.”<sup>33</sup>

### 5.1.13. Nga ne kërkohet ta ndjekim të vërtetën

Dallimi në mendime nuk është leje për secilin të përzgjedhë atë që përkon me tekat dhe qejfet e tij. Dijetarët janë të një mendjeje se kjo sjellje përbën *fisk*.<sup>34</sup> Secili duhet të mundohet të ndjekë qëllimin hyjnor të legjislacionit brenda kapacitetit të vet. Një muxhtehid është i obliguar të nxjerr vendime për vetveten, edhe nëse një dijetar më i madh në pozitë thotë ndryshe. Një *mukallid*, sipas mundësive që ka, është i obliguar të kërkojë më të dijshmin e më të besueshmin mes dijetarëve dhe t'i përmbahet asaj që ai cakton të jetë qëndrimi më i fortë. Nëse dy prej dijetarëve bien në kundërshtim, ai duhet të bëjë krejt çfarë ka mundësi që t'i peshojë provat e ofruara. Nëse ai nuk kupton diskutimin, mund të zgjedhë cilindo nga dy qëndrimet e dijetarëve pa ndonjë pengesë a ndalim.

Esh-heb, një student i Imam Malikut, tha: “Dikush pyeti Malikun nëse njeriu është i sigurt të ndjekë cilindo vendim që dëgjon nga ndonjë nga Sahabët dhe ai u përgjigj: ‘Jo, pasha Allahun, përveç nëse ai vendim është i saktë. Sepse e vërteta është vetëm një.’”<sup>35</sup>

Shmangu nga të folurit me siguri në çështjet ku ekspertët nuk pajtohen. Sahabët gjithmonë theksonin se përfundimet që ata nxirrnin, nuk ishin patjetër ajo çfarë Allahu kishte për qëllim. Ibn Mes'ud ؓ, për shembull, thoshte:

“... Nëse vendimi im është i saktë, është nga Allahu; nëse është i gabuar, është nga unë dhe nga shejtani, ndërsa Allahu dhe i Dërguari i Tij janë të pastër nga kjo.”<sup>36</sup>

## 5.2. Rekomandime specifike

<sup>33</sup> Es-Sexhistaani, Ebu Daud, *es-Sunen*, hadithi 4800

<sup>34</sup> *Fisk*: Sjellje e devijuar; lënia e mënyrës së duhur apo lënie e së vërtetës në kundërshtim ndaj Allahut; sjellje e pamoralshme.

<sup>35</sup> El-Khatib, Ebu Daud, *es-Sunen*, hadithi 4800

<sup>36</sup> Es-Sexhistaani, Ebu Daud, *es-Sunen*, hadithi 4800

Secili lloj i mospajtimit kërkon një trajtim të ndryshëm.

### 5.2.1. Dallimi mes feve

Diskutimi këtu bëhet për të treguar të vërtetën, jo për ta zbuluar atë apo për të gjetur një mesatare.

Bashkëpunimi ka të bëjë me të mirën e përbashkët për tërë njerëzimin: drejtësi, paqe, siguri, mbrojtje të ambientit, etj.

### 5.2.2. Dallimet mes grupeve islame

Bashkëpunimi këtu është sikur ai me jomuslimanët. Krahas kësaj, këta kanë të drejtat e përgjithshme të muslimanëve, nëse bidati i tyre nuk i nxjerr nga suazat e Islamit. Prej këtyre të drejtave është t'i mbështesim kundër armiqve të tyre, nëse u bëhet e padrejtë.

### 5.2.3. Përbrenda Ehlus-Sunetit

#### i. Sunneti karshi Bidatit dhe e Vërteta karshi Pavërtetësisë

Dëno pozicionin e rremë dhe mos i jep shtysë në asnjë mënyrë, qoftë drejtpërsëdrejti, qoftë tërthorazi.

Nëse bidati s'është një incident i izoluar i devijimit dhe është një model sjelljeje për të cilin njihet personi, ti duhet të paralajmërosh kundër devijimit të tij, nëse ai është person me ndikim dhe njerëzit devijojnë nga Suneti nëpërmjet tij.

Kur devijimi ndikon parimet e akidesë dhe bazat e fesë, ne s'duhet të kërkojmë unitet të umetit në dëm të besimit. Umeti nuk vlen gjë pa Islam. Kujto qëndrimin e Ebu Bekrit ؓ kundra atyre që refuzuan obligimin e zekatit dhe atyre që pretendonin pejgamberllëk.

#### ii. E Saktë karshi Pasaktë

Dallimet e pajustificueshme.

- Dëno pozicionin e rremë dhe mos i jep shtysë në asnjë mënyrë, qoftë drejtpërsëdrejti, qoftë tërthorazi.

- Nëse personi në përgjithësi i përmbahet Sunetit, mos ceno besueshmërinë e tij.

#### Dallimet e justifikueshme

- Dallimet e vogla karshi dallimeve të mëdha
- Këshillo vëllezërit e tu për pikëpamjet më të mundshme (më të sakta) pa e dënuar pozicionin e tyre
- Ji më kategorik lidhur me dallimet më të vogla; prapë pa i dënuar drejtpërsëdrejti

#### iii. Dallimet në variacione

Dallimet për të cilat as që kërkohet pajtim. Nëse ka mënyra të ndryshme të bërjes së një akti, atëherë secili është i lirë të zgjedhë mënyrën e vet të preferuar. Kur kjo ka të bëjë me individë e grupe të ndryshme që kryejnë funksione të ndryshme, një llojllojshmëri e këtyllë duhet të inkurajohet, sepse asnjë individ apo grup nuk është në gjendje të përmbushë të gjitha detyrat në këtë umet. Duhet bërë balancim. Përçmimit të punës së të tjerëve duhet t'i shmangemi krejtësisht.

Në fund, duhet të ketë një dallim në trajtimin e atyre që arrijnë në përfundime të gabuara, për shkak të dështimit në qëllim, dhe të atyre që gabojnë, për shkak të dështimit në gjykim.

Allahu bashkoftë umetin në mirësi!